



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-7244/26  
Kaçanik, 30.03.2026

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (b), (c), (f) të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 4 paragrafi 2, pika 2.4 e Ligjit 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 52/08 maj 2009), të neni 6.2 (f) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut 01Nr. 104/02-7244/26 nëpërmjet të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kuvendi i Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 mars 2026. mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR SHPALLJE NË INTERES PUBLIK TË PARCELAVE KADASTRALE**  
**NË ZK KAÇANIK, NË EMËR TË MUHARREM (ADEM) BERISHA**

1. Me këtë Vendim, **SHPALLET** me interes publik parcela e pronës së paluajtshme në ZK KAÇANIK, me pronësi private të personit fizik, Muharrem (Adem) Berisha.
2. Sipas pikës 1. të këtij vendimi, shpallet me interes publik parcela e pronës, si vijon:  
2.1 Parcela Kadastrale P-70917048-01110-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej  $S= 304 m^2$ , në pronësi të Muharrem (Adem) Berisha me vendndodhje në Rr. Ismail Raka, ZK Kaçanik. (të shpallet me interes të përgjithshëm publik patundshmëria me sipërfaqe  $9 m^2$ , e cila nevojitet për rregullimin e rrugës).
3. **Shpallja** e interesit publik të pronës së përcaktuar në këtë vendim, bëhet me qëllim që kjo pronë të kalojnë në pronësi të komunës së Kaçanikut, pas një procedure të shpronësimit, për realizimin e interesit publik- zgjerimin e rrugës.
4. Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, respektivisht 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

**Me këtë Vendim njoftohen:** MAPL; Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Selajdin Troni



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	04.05.2026	Vendi	Kaçanik
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
			01-104/02-	10174/26



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Nr. Prot. Org. Jedinica Org. Unit	OL
Nr. Prot. Prot. No.	1807-2/26
Nr. I faqeve Regjistranca No. pages	- 02 -
Data. Datum:	30.04.26
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për:	Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në VL 51/26 MMPH Datë: 15.04.2026
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues vlerësimit ligjor Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendim 01Nr.104/02-7244/26 për shpallje në interes public të parcelave kadastrale në ZK Kaçanik, në emër të Muharrem (Adem) Berisha

I nderuar kryetar Vishi,  
I nderuar kryesues Troni

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 08.04.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 01Nr.104/02-7244/26 për shpallje në interes publik të parcelave kadastrale në ZK Kaçanik, në emër të Muharrem (Adem) Berisha

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave konstatoi se:

Prona e shpallur me interes publik sipas Vendimit 01Nr.104/02-7244/26 miratuar nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut është pronë private.

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-205, Komuna ka të drejtë të realizojë shpronësimin e pronave private brenda territorit të saj për zbatimin e projekteve në interes publik, të planifikuara sipas dokumenteve përkatëse. Rrjedhimisht, Komuna është vetë organi shpronësues.

Në rastin konkret, procedura e shpronësimit duhet të zhvillohet nga Kryetari i Komunës, ndërsa Departamenti i Shpronësimit nuk ka obligime në këtë procedurë dhe nuk duhet të përmendet në asnjë pjesë të vendimit. Procedura duhet të zhvillohet në përputhje me nenin 4, paragrafi 2 të ligjit përkatës, ndërsa nxjerrja e vendimeve duhet të bëhet në përputhje me nenet 8, 10 dhe 11 të po këtij ligji.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbetet në dispozicion të Komunës së Kaçanikut dhe MAPL-së për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

